



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief
State Prosecutor

A.nr.429/2024

Datë: 05.09.2024

Prishtinë

Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurori i Shtetit, pas pranimit të kërkesës së datës 29.08.2024, nga Prokurorja Speciale znj. Ilirjana Çollaku, për udhëzim lidhur me zbatimin e nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4.6 të Ligjit 08/L-168 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 20 paragrafi 1 nënparagrafi 1.9 të Ligjit nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, me qëllim të zhvillimit efikas të procedurës, shmangies së neglizhencës dhe mos zbatimit të ligjshmërisë, nxjerr këtë:

UDHËZIM

Për zbatimin e dispozitës së nenit 8 paragrafi 3 të Ligjit 08/L-168 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, për rastet kur prokurori i Prokurorisë Speciale është i dyshuar për vepër penale të korrupsionit

Sipas dispozitës së nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafët 1.4.5 dhe 1.4.6, lidhur me nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.14 të Ligjit 08/L-168 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, është përcaktuar së për veprat penale të korrupsionit, gjyqtarët dhe prokurorët bien në kompetencë të veçantë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Meqenëse këto dispozita të Ligjit 08/L-168 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, nuk ka përjashtuar prokurorët e Prokurorisë Speciale, me qëllim të zhvillimit efikas të procedurës, shmangies së neglizhencës dhe shmangies së mos zbatimit të ligjshmërisë, konsideroj si të nevojshme që Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, në rastet kur prokurori i Prokurorisë Speciale është i dyshuar për vepër penale të korrupsionit, të zbatojë dispozitën e nenit 8 paragrafi 3 të Ligjit 08/L-168 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, e cila ka përcaktuar së “me autorizimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale,

prokurorët specialë mund të delegojnë të çdo prokurori themelore ndërmarrjen e veprimeve të caktuara hetimore të procedurës penale ose kryerjen e hetimeve apo ndjekjen penale të lëndëve për të cilat është kompetente Prokuroria Speciale”, andaj në rastet e tilla çështja penale duhet të delegohet për ndjekje penale në ndonjë prokurori tjetër, në mënyrë që të shmanget çdo mundësi e neglizhencës apo mos zbatimit të ligjit, si dhe perceptimi për ndonjë konflikt eventual të interesit.

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Besim Kelmendi
UD Kryeprokuror i Shtetit



- Udhëzimi i dërgohet: Kryeprokurorit dhe prokurorëve të PSRK-së dhe Arkivit të ZKPSH-së.
- Obligohet administrata e ZKPSH-së që këtë udhëzim ta publikoj në ueb-faqen e Prokurorit të Shtetit.